



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:168956

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05514779

C.nr. 2006/21

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, me gjyqtarin Besnik Shala, në çështjen juridike kontestimore të paditësit D.L, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi ligjor R.L nga P rr....., nr....., të cilin e përfaqëson Av. B.A nga P, kundër të paditurës K.S.E” në P, Rr. “.....”, nr.4, e përfaqësuar nga V.K sipas autorizimit, me objekt kontesti Kompensim Dëmi sipas auto-përgjegjësisë, me vlerë të kontestit 36.904,35 Euro, në prezencën e të autorizuarve të palëve ndërgjyqës, pas seancës se shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 01.03.2024, ndërsa me datë 27.03.2024, përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses: paditësit D.L, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi ligjor R.L nga Peja rr....., nr....., ashtu që:

I. DETYROHET e paditura K.S.E me seli në P, (për përgjegjësin e ndarë prej 80% me 20% në disfavor të paditurës) që paditësit Diar Lajqi, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi ligjor R.L nga Peja, në emër të kompensimit të dëmit jo material të pësuar në aksidentin e datës 03.07.2021, t’ia paguaj shumat dhe atë për:

Demin jo material:

- a. në emër të dhimbjeve fizike shumen prej 5,500,00 euro,
- b. në emër të frikës së përjetuar shumën prej 4.000,00 euro,
- c. në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësore shumën prej 4.000,00 euro,
- d. në emër të shëmtimit shumën prej 1.500 euro,

Te gjitha këto si në piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimi me kamat ligjore prej 8% në vit, nga data 27.3.2024 (dita e përpilimit të aktgjykimit), e deri në pagesën definitive, në afate prej 15 dite nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e nën kërcenim të përmbarimit të dhunshëm,

II. DETYROHET e paditura K.S.E me seli në P, (për përgjegjësin e ndarë prej 80% me 20% në disfavor të paditurës) që paditësit D.L, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi ligjor R.L nga P, në emër të kompensimit të dëmit material të pësuar në aksidentin e datës 05.09.2018, t’ia paguaj shumat dhe atë:

Demi material

- a. Në emër të mjekimit shumen prej 2.395,35 euro,
- b. në emër të kujdesit dhe ndihmës së huaj shumen prej 700,00 euro,
- c. në emër të ushqimit të përforcuar shumen prej 560,00 euro,
- d. në emër terapisë fizikale shume prej 150,00 euro,

Të gjitha këto si në piken II të dispozitivit të këtij aktgjykimi me kamat ligjore prej 8% në vit, nga data 30.07.2021, (nga dita e parashtrimit të padis), e deri në pagesën definitive, në afate prej 15 dite nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcenim të përmbarimit të dhunshëm.

- III. REFUZOHET pjesërisht si e pabazuar**, kërkesë padia e paditësit D.L, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi ligjor R.L nga P, përtej shumës së gjykuar, si në piken I, në dispozitivin e këtij aktgjykimi, për aksidentin e datës 03.07.2021, për shumatat e specifikuar si më poshtë, dhe atë për:

Demin jo material:

- a. në emër të dhimbjeve fizike shumen prej 1.500,00 euro,
- b. në emër të frikës së përjetuar shumën prej 2.000,00 euro,
- c. në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësore shumën prej 1.000,00 euro
- d. në emër të shëmtimit shumën prej 2.500,00 euro,

Demi material

- a. Në emër të mjekimit shumen prej 6.509,00 euro
- b. në emër të kujdesit dhe ndihmës së huaj shumen prej 2.300,00 euro,
- c. në emër të ushqimit të përforcuar shumen prej 440,00 euro,
- d. në emër terapisë fizikale shume prej 850,00 euro,

- IV. DETYROHEN** të paditura K.S.Eurosig” me seli në P, që paditësit D.L, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi ligjor R.L nga P ti paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 1.826,00 euro, e të gjitha këto në afat prej 15 dite, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e nën kërcenim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurës K.S.E me adresë rr.“.....” nr....., P, e përfaqësuar nga z. V.K sipas autorizimit, me objekt

kontesti Kompensim dëmi, sipas auto-përgjegjesisë, me vlerë të kontestit 36.904,35 Euro, e të precizuar me parashtrësën e datës 29.01.2024.

I autorizuari i paditësit me padi, gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: mbesim në tersi pranë padisë dhe kërkesës së saj si qëndrojmë në pranë deklarimeve të deritanishme, si dhe parashtrësës mbi rregullimin e padisë të dt.29.01.2024, provave të propozuara , duke vlerësuar se në provat e propozuara dhe të administruara nga ana gjykatës është vërtetuar në tersi baza juridike dhe lartësia e kërkesëpadisë, duke kërkuar që me rastin e vendosjes gjykata të ketë parasysh të gjitha provat e administruar posaçërisht, ekspertizën e komunikacionit të dt.30.10.2023, si dhe mendimin dhe konstatimin e dhënë nga ekspertet mjekësore Dr. V.B, F.Sh, Z.B dhe Z.M, dhe sa i përket dëmit material dhe jo material, në emër të zhdëmtimit-kompensimit të dëmit nga baza e auto-përgjegjesisë për aksidentin e dt. 03.07.2021, i kemi kërkuar në mënyre të specifikuar me parashtrësën e dt. 29.01.2024, po ashtu shpenzimet procedurale i kërkojmë në mënyre të specifikuar.

I autorizuari i të paditurës se me përgjigje në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: mbesim në tërësi si në përgjigjen në padi dhe në deklarimet nga seancat e kaluara, ku ritheksojmë se për të paditurën nuk është kontestuese baza juridike e saj, por vazhdon të jetë kontestuese lartësia e kërkesës së saj, pasi që e njëjta nuk është në harmoni me natyrën lëndimeve e as me praktikën e cila është vendosur sipas rregullores së BQK-së ku shumat e kërkuara nga pala paditëse janë tejet të larta dhe nuk janë në harmoni me natyrën e lëndimeve që i ka precizuar paditësja në këtë aksident ku lëndimet janë të natyrës së lehtë, ndërsa sa i përket precizimi të kërkesëpadisë e paditura e konteston pasi që vlera e kërkuara në precizim janë të larta e të cilat nuk janë në harmoni me të cilat i ka pësuar paditësja dhe me praktikën gjyqësore. Sa i përket shpenzimeve të procedurës kontestimore kërkojmë nga gjykata të ia njohë sipas suksesit në procedurë e po ashtu sa i përket kamatës ligjore të vendosë në shkallën prej 8 % nga dita e vendimit. Sa i përket me sa u tha me lartë kërkojmë nga gjykata që padinë dhe kërkesëpadisë e paditëses ta aprovoj pjesërisht si të bazuar për natyrën e lëndimeve të lehta të pësuar duke i refuzuar pjesërisht shumat e kërkuara në precizim.

Gjykata në këtë çështje juridike – kontestimore më qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar provat siç janë: certifikata e lindjes për D.L, letërnjoftimi kopje për R.L, raporti i aksidentit fillestar me nr. Te rastit 2021-DA-535 dt. 03.07.2021, raporti i Emergjencës me nr. Rendor 11280 për D.L, CD e RTG për D.L, raporti nga konsulta i dt. 04.07.2021, raporti nga konsulta dt 07.07.2021, raporti specialist ik me nr. 60205 09.05.2021, raporti specialistik bashke me kupon fiskal nga Titan dt. 14.07.2021, raporti specialistik bashke me kupon fiskal nga Titan dt. 17.07.2021, 13 foto të formatit A4 në Color, procesverbal mbi vend shiqmin e aksidentit me nr te rastit 2021-DA-535 dt. 20.07.2021, raporti nga konsulta i dt. 02.08.2021, flete lëshimi nga QKUK me nr ames 4710 i dt. 02.08.2021 për D.L, raporti specialistik bashke me kupon fiskal nga Titan dt. 04.08.2021, raporti specialistik bashke me kupon fiskal nga Titan dt. 07.08.2021, 12 kupona fiskal, raporti i dt. 22.07.2021, 3 tiketa të parkingut, raporti specialisti i dt. 09.08.2021 nga DR. A.K dt 09.08.2021, raporti specialisti nga DR. E.H dt. 12.08.2021, raporti specialisti nga DR. J.U dt. 16.08.2021, raporti specialisti nga DR. A.K dt. 19.08.2021, raporti specialisti nga DR. Enver

Hoxha dt. 26.08.2021, raporti specialisti nga DR. Enver Hoxha dt. 23.09.2021, raporti specialisti nga DR. E.H dt. 07.10.2021, raporti specialisti nga DR. Enver Hoxha dt. 04.11.2021, 36 kupona fiskal, 10 fatura te parkingut, 68 kupona fiskal, dy fatura te parikgut, raporti specialisti nga DR. E.H dt. 21.07.2021, fatura nga American Hospital Kosova Shpk dt. 21.07.2021, kuponi fiskal te te njetes pageese, raporti fizio-terapeutik i dt. 30.12.2021, 9 foto te formatit A4 në color, raporti specialisti nga DR. E.H dt. 09.12.2021, fatura nr. PLA 365777 , raporti specialisti nga DR. Enver Hoxha dt. 03.02.2022, fatura me nr. PLA 377884, raporti specialisti nga DR. Enver Hoxha dt. 10.03.2022, fatura PLA 386729, fatura nr. 8811/2022, nje kupon fiskal ne shume prej 100 eruo, raporti nga Avicena Ks bashke me kupon fiskal, fatura nr. 22783036 dt. 07.04.2022, fatura 60/2022 Kosova Travel, fatura 61/2022 Kosova Travel, raporti me nr. 360878 nga Memorial bashke me kupon fiskal, raporti i dt. 07.04.2022 me nr. 7030838, raporti për D.L i dt. 04.04.2022, raporti i epikrizes per D.L me nr. 7030838, 33 kupona fiskal dhe 1 tikete parkingu, 3 bileta te avionit, fatura me nr. 41467 e dt. 06.05.2022, fatura me dt. 06.05.2022, 10 kupona fiskal, dy rezervime për avion, fatura e dt. 06.05.2022 me nr. 41467, fatura e dt. 05.06.2022, raporti nga konsulta i dt. 13.01.2023, fatura nga AKAT shpk bashke me kupon fiskal, fatura nga AKAT shpk bashke me kupon fiskal, 24 kupona fiskal, raporti fizio-terapeutik i dt. 21.06.2022, fatura me nr 376/2023 e dt. 21.01.2023 bashke me kupon fiskal, raporti fizio -terapeutik me nr. 376/2023, 6 CD, deklarata e edukatores M.F bashke me kërkesë, raporti Logopedik, certifikata për D.L, certifikata për D.L, ekspertiza e komunikacion rrugor e dt. 30.10.2023, ekspertiza mjekësore e dt. 27.12.2023.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç, dhe të gjitha së bashku në lidhmëni me njëra tjetrën, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata erdhi në përfundim se në këtë çështje juridiko – kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se me datën 03.07.2021, rreth orës 18:50 minuta në Pejë te qendra tregtare LC Waikiki, kishte ndodhur aksidenti i komunikacionit rrugor me lëndime trupore te të miturit D.L, dhe automjetit Volksvagen tipit Tauran me targa 03-638-FS i vitit 2011 qe e drejtonte Jeton Shehu, e ku automjeti ishte i siguruar tek këtu e paditura K.S.E sh.a.,

Meqë ishte kontestuese pjesërisht baza juridike e kërkesëpadisë sa i përket përgjegjësisë edhe të këmbësorit të përfshirë në këtë aksident, e sipas propozimit të autorizuarit të paditure që te merret prova me ekspertizë nga lëmia e komunikacionit, gjykata me aktvendimin e datës 18.10.2023, kishte aprovuar këtë propozimi dhe kishte caktuar ekspertin A.L nga lëmia e komunikacionit për të përpiluar ekspertizën.

Eksperti A.L nga lëmia e komunikacionit me ekspertizën e datës 30.10.2023, kishte konstatuar se: Në bazë të materialit të prezantuar nga Gjykata, analizës - rrjedhës teknike të aksidentit dhe konstatimit, jam i mendimit se deri të aksidenti i komunikacionit ka ardhur, me kontributin e drejtuesit të automjetit A: Lëshimet e drejtuesit të automjetit A (Volkvagen) që kanë ndikuar ne aksident: E ka nënvlerësuar prezencën e fëmijës që ishte duke kaluar rrugën tërthorazi nga e majta në të djathtë shikuar drejtimin e tij të lëvizjes, duke mos reaguuar në

zvogëlimin e shpejtësisë me të parë prezencën e fëmijës në atë pjesë të rrugës, pasi që të njëjtën me pjesën e përparme të anës së majtë të automjetit e ka goditur duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore, Mos përshtatja e shpejtësisë, gjegjësisht mos reagimi me kohë në zvogëlimin e shpejtësisë me të parë prezencën e fëmijës në rrugë, ka qenë shkaku që është ardhur deri të aksidenti i komunikacionit, njeherit shpejtësia e madhe në momentin e goditjes ka ndikuar në pasojat me lëndime të rënda për fëmijën. Aksidenti i trafikut ishte shkaktuar në rrugë ku është e frekuentuar nga këmbësoret, Lëshimet këmbësorit: Këmbësori - fëmija e moshës rreth 6 vjeçare në vendin ku ka filluar kalimin tërthor të rrugës, me ç ‘rast fëmija i moshës së tillë nuk mund të perceptojë saktë situatat në komunikacion, (rendësin e sigurisë, si dhe pa mundur që ta vlerësojë drejtë largësinë dhe shpejtësinë e automjetit (A), por është obligim Ligjor i drejtuesve të automjeteve që të kenë kujdes të veçanët pranë kalimit afër fëmijëve (ta zvogëlojnë shpejtësinë sipas nevojë deri në minimum në mënyrë që në çfarë do rrethane të mund ta ndalin mjetin).

Pas pranimit të ekspertizës palët ndergjyqjse nuk kishin vërejtje në të njëjtën dhe nuk kishin pyetje për ekspertin dhe as që kërkonin sqarime shtesë dhe në seancën e datës 23.11.2023, ku dhe pala e paditur e kishte pranuar përgjegjësin për 80% të shkaktimit të aksidentit, gjykata i falë besimin e ekspertizës së ekspertit të komunikacionit pasi që e njëjta ishte e bazuar në provat të cilat ishin në shkresë të lëndës dhe palët nuk kishin vërejtje në të njëjtën si në deklaratat e dhëna në seancën e datës 23.11.2023.

Duke u bazuar në nenin 147 par 1 të LMD-së i cili parasheh “Prindërit përgjigjen për dëmin që i shkakton tjetrit fëmija i tyre deri në moshën shtatë vjeçare, pavarësisht nga fajti i tij” andaj prindërit është dashur të kujdesen për fëmijën e tyre në momentin kur kanë dalë në rrugë për çka dhe duke u bazuar në ekspertizën e komunikacionit dhe deklaratat të palëve lidhur me përgjegjësinë e ndarë 20 % me 80% e ku për gjykatën kjo ndarje e përgjegjësisë është edhe në përshtatshmëri me lëshimet e shoferit të automjetit dhe të këmbësorit këtu paditësit

Sipas dispozitës së nenit 136.1 të LMD-së, parashihet se kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë të ja kompensoi, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij, ndërsa me dispozitën e nenit 140, parashihet se fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia, kurse me dispozitën e nenit 159.1 parashihet se “ në rast aksidenti të shkaktuar nga automjeti në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit ”.

Për të vërtetuar lartësinë e kërkesëpadisë, gjykata sipas propozimit të palëve, në cilësinë e provave materiale ka nxjerrë ekspertizën mjekësore nga lëmia e ortopedisë dr. V.B, nga lëmia e psikiatrisë dr. F.Sh, nga lëmia e kirurgjisë plastike dr. Z.B dhe nga lëmia e logopedisë dr. Z.M, të gjitha të punësuar në QKUK në Prishtinë, pas ekzaminimit të drejtpërdrejt të datës 15.12.2023, dhe dokumentacionit mjekësor të bashkangjitur në shkresë të lëndës kanë konstatuar se: i mituri D.L ka pësuar lëndime të rënda trupore, ndrydhje në regjionin e kokës, amputim traumatik të gishtit të V (pestë) të dorës së djathtë, prerje të tetivave të thella dhe sipërfaqësore të gishtit të pestë, plagë shqyerës në gishtin IV të dorës së djathtë, ndrydhje në regjionin e gjurit të djathtë, gërvishtje multiple përgjatë trupit, dhe i është nënshtruar dy intervenimeve kirurgjikale dhe atë të fiksimit të gishtit të pestë dhe qepjes të tetivave fleksore, me dhembje fizike posaçërisht të rënde

për një orë, duke marrë parasysh vendndodhjen e aksidentit, transportit për në spital, me intensitet të rënde 3 ditë kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë kundër dhembjes, të intensitetit të mesëm 30 ditë kohë e nevojshme për tërheqjen e edemës dhe hematomave në regjionet e lënduara të gishtit të pestë si dhe fillimit të rikuperimit të indeve të buta dhe tetivave të këputura fleksore, me intensitet të ulët që posedon akoma në lëvizje të gishtit të V të dorës së djathtë i cili është me ankillozë të nyjës interfalageale, i mituri D.L ka përjetuar frikë primare të intensitetit të lartë që ka zgjatur për disa sekonda me humbje të vetëdijes, frikë sekondare të intensitetit të lartë që nga momenti i aksidentit e deri në kryerjen e analizave dhe ekzaminimeve mjekësore ka zgjatur 24 orë, të manifestuara me ngushtim të vetëdijes si dhe pas rikfjelljes së vetëdijes është përcjell me frikë të madhe ndaj vdekjes, i njëjti ka pasur paaftësi për tu qetësuar emocionalisht për shkak të pamjes së plagës së hapur dhe gjakosur, frikë sekondare të intensitetit mesatar që ka zgjatur 4 javë gjendje kjo e vazhdimit të vizitave mjekësore, në raportin e psikiatrit të dt.07.07.2022, që shpesh herë ka pasur ndërprerje të komunikimit duke mos pasur qasje me askënd, dhe vështirësi në të shprehur-belbëzim dhe reagime të pa pritshme,, e gjithë kjo situatë shoqërohej me simptoma përjetuese shmangëse të lidhura me frikën, e që karakterizohet me paaftësi për të mësuar, kuptuar, në shkrim e lexim, të dhëna këtë të marra nga heteroanamneza kryesisht nga nëna, këto simptoma kanë vazhduar me frikë sekondare të intensitetit të ulët edhe sot kësaj dite duke pasur pengesa në të shprehur verbal, sjelljet, kontaktit me persona të ri, e këtë situatë e ka rënduar edhe me shumë bullizimi(ngacmimi) nga nxënësit e klasës, e që kanë vazhduar të jenë të pranishme lidhur me disponimin, frika e herë pas hershme natën, probleme me mësim që ka ndikuar në rënie e përfomancës suksesit në shkollë, Fëmija D.L si pasojë e aksidentit ka përjetuar çrregullim të artikulimit të fjalëve, çrregullim në të folur, ka shëmtim të shkallës së ulur për shkak të pozitës së gishtit të V të dorës së djathtë i cili nuk mund të flektohet e as të ekstendohet, ka divijim radial të falangës distale dhe devijim ulnar të falangës mediale i cili vërehet sidomos kur bëhet mbledhja dhe shtrirja e gishtërinjve tjerë, ku vërehet se gishti V nuk mund të mblidhet e as të shtrihet, zvogëlim të aktivitetit jetësor është në shkallën prej 10% dhe atë prej shkak të ankilozës (shtangimit) e të dy nyejve (PIP dhe DIP) të gishtit të vogël (pestë) të dorës dominante në pozitë jo funksionale prej 6%, kapitulli I pika 1,5,9 dhe -5% si pasojë e çrregullimit në të folur, ndihma e personit ët tretë ka qenë e nevojshme për 70 ditë sa e ka pasur të imbolizuar gishtin e V, ushqim të përforcuara 70 ditë i pasur me proteina, vitamina, minerale si dhe rehabilitim fiziko-terapeutik ka qenë e nevojshme prej 30 ditësh në vitin e parë pas aksidentit dhe nga 15 ditë në vitin e dytë dhe terte pas aksidentit.

Gjykata në tersi i ka falur besimin konstatimeve të eksperteve përkatës, të njëjtat përputhen në mes veti si dhe provat tjera e posaçërisht me dokumentacionin mjekësor që ju është bashkangjitur shkresave të lëndës dhe gjithashtu palët ndërgjyqësve pas pranimit të ekspertizës së datës 27.12.2023, në seancën e datës 01.03.2024 kanë deklaruar se nuk kërkojnë sqarime dhe nuk kanë pasur pyetje për ekspertet dhe nuk kanë pasur vrenjtje në ekspertizën e datës 27.12.2023, për çka gjykata i fali besimin e plotë mendimit të eksperteve.

Për lartësinë e kërkesë padisë dhe për kategoritë e caktuara për aspektin e dëmit jo material gjykata vendosi duke u mbështetur në dispozitat e nenit 183 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, e lidhur me nenin 323 të ligjit për Procedurën Kontestimore, me këtë rast gjykata pati parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës, dhe qëllimin të cilit i shërben kompensimi i

gjykuar, gjithmonë duke pasur parasysh, që kompensimi të jetë satisfaksion për të dëmtuarin, duke ndikuar kështu në zbutjen e pasojave negative që janë paraqitur si pasojë e dëmit në cenimin e vlerave personale të paditësit.

Gjykata pasi konstatoi rrethanat e rastit duke pasur parasysh përgjegjësinë e pjesëmarrësve në këtë aksident për lartësinë e kompensimit për këtë kategori të dëmit jo material, mori parasysh natyrën e lëndimeve trupore të cilat i kishte pësuar paditësi në aksidentin e ndodhur, mënyrën e manifestimit, intensitetit dhe kohëzgjatjen e frikës se përjetuar, dhe moshën e paditësit i cili në kohën e aksidentit ishte 6 vjet, sipas gjetjeve të bëra nga ekspertët mjekësor, por edhe praktikën e gjertanishme gjyqësore, duke u siguruar që kompensimi në shumën e gjykuar për këtë lloji dëmi të jetë satisfaksion për paditësen, e duke shmangur qëllimet tjera materiale (lukrative) që mund të bien ndesh me qëllimin e kompensimit në raste të tilla, praktikën e mirë gjyqësore, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit në pjesën e aprovuar, si dhe duke iu referuar paragrafit 2 të nenit 183 të LMD-së përcaktohet se “me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me të mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe qëllimin shoqëror”. Pra, nga kjo dispozite ligjore rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me kohëzgjatjen e dhimbjeve të përjetuara, ashtu që kompensimi të përfaqësojë një lehtësim në përballje të tejkallimit të pasojave që në këtë rast paditësi ka pasur në aksidentin e datës 03.07.2021. Ndërsa lidhur me kompensimin e dëmit jo material për shëmtim gjykata i mori përbazë gjitha rrethanat dhe duke u bazuar në mendimin e eksperteve se lloji i shëmtimit e i cili konsiderohet i shkallës së ultë për shkak të [pozitës së gishtit të V të dorës së djathtë e i cili nuk mundet të flektohet e as të ekzandohet ka devijim radial të falangës distale dhe devijim ulnar të falangës mediale e i cili vërehet sidomos kur behet mbledhja dhe shtrirja e gishtërinjve të tjerë ku vërehet se gishti i V nuk mund të mblidhet e as të shtrihet, andaj në bazë të mendimit të ekspertëve dhe duke pasur parasysh vendin e shëmtimit dhe moshën e paditësit gjykata vendosi se kompensimi në lartësinë e gjykuar si në pikën I është i drejt dhe në harmoni me pasojën që i është shkaktuar të miturit paditësit në ditën e aksidentit.

Gjykata vlerëson se shpërblimi i dëmit jo material, nuk është shpërblim i plotë, por është satisfaksion, për të dëmtuarin, çka në rastin konkret shumat e gjykuara si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi janë të drejta për paditësin.

Sipas vlerësimit të Gjykatës kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar lidhur me pjesën e kërkesëpadisë rreth kompensimit të dëmit material dhe atë: shpenzimet e mjekimit për ndihmën dhe kujdesin e personit tjetër, për ushqimin e përforcuar, dhe për terapi fizikale, për arsye se me nenin 179 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: “Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet e tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të pa aftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit”. Në këtë rast paditësit i takon e drejta në kompensimin e dëmit material, për pikën e aprovuar pasi që me fletëpagesat e bashkangjitura si provë vërtetohet lartësia e shpenzimeve të mjekimit dhe atë për shumën prej 2.994,18 euro, mirëpo duke pasur parasysh ndarjen e përgjegjësisë shuma që i takon si kompensim është 2.395,35 euro, e aprovuar

si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për ndihmën dhe kujdesin e huaj dhe ushqimin e përforcuar, edhe përkundër faktit se paditësi për këto kategori të dëmit nuk ka prezantuar prova konkrete materiale, kjo gjykatë vlerëson se duke u nisur nga praktika e gjertanishme e gjykatave në Kosovë, në bazë të së cilës është konstatuar se në shumicën dërmuese të rasteve palët kanë të pamundur apo shumë të vështirë që të sigurojnë dëshmi konkrete për këtë lloji dëmi, pasi që kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjarët e tyre dhe ushqimi i përforcuar i cili përfshinë ushqim shtesë të ushqimit të zakonshëm është vështirë të argumentohet me prova konkrete, gjykata ka konstatuar se në këtë rast paditësit të miturit D.L ka pasur nevojë për ndihmë të huaj në kohëzgjatje prej 70 ditësh, dhe ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 70 ditësh, ku të njëjtit i takon ky lloji kompensimi i kërkuar në shumat e gjykuara. Ndërsa në këtë rast lartësia e kërkesës për këto kategori të dëmit është reale në raport me kohëzgjatjen për nevojën për ndihmë dhe kujdes nga personi i tretë dhe ushqimin e përforcuar. Ndërsa për dëmin material për terapi fizikale në bazë të raportit mjekësor dhe mendimi të ekspertëve paditësi ka pasur nevojë për terapi fizikale e ku si provë ka bashkangjitur faturën e lëshuar nga dr. M.B B.I. N.SH. Fizio Plus, në shumë prej 150 euro, dhe kuponin fiskal për pagës, gjykata vendosi që të aprovet kjo lartësi për këtë kërkesë të dëmit material si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Për pjesën e refuzuar të kërkesë padisë, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, që ndërlidhet me dëmin jo material, pasi që vlerësoi se kompensimi përtej shumës së gjykuar, nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur, dhe me qëllim që kompensimi të ishte i drejt.

Për pjesën e refuzuar të kërkesë padisë, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, që ndërlidhet me dëmin material si shpenzime të mjekimit në shumë prej 6.509,00 euro, duke pasur parasysh se pala paditëse në shkresa të lendes ka dorëzuar edhe kuponë fiskal për karburant për vetura dhe atë në shumë prej 730,00 euro, dhe gjithashtu i njëjti ka dorëzuar edhe një profatur në shumë prej 3.500,00 euro të lëshuar nga Memorial Instambul mirëpo i njëjti nuk ka bashkangjitur dëshmi mbi pagesën e të njëjtës për çka edhe gjykata vendosi që të i refuzoj kërkesat për këto pjesë. Ndërsa për kujdes dhe ndihmë të huaj shumen prej 2.300,00 euro, për ushqim të përforcuar shumen prej 440,00 euro, dhe për terapi fizikale në shumë prej 850,00 euro, pasi që gjykata vlerëson se paditësi nuk e ka argumentuar me asnjë provë kërkesën e tij për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që sipas dispozitës së nenit 7 të LPK-së, palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta, dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa sipas dispozitës së nenit 319 të LPK-së, secila palë ndërgjyqëse, ka për detyrë të provoi faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta, andaj nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendimin për kamatën e ka mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së, për dëmin jo material konsideron se nga momenti i përpilimit të aktgjykimit (datë 27.03.2024) pala e paditur bie në vonesë dhe është e detyruar, që përveç dëmit të paguaj edhe kamatë, se nga ky moment kupton për llojin dhe vëllimin e dëmit të shkaktuar, andaj edhe është vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ndërsa sa i përket dëmit material gjykata konsideron se nga momenti i parashtrimit të padisë në gjykatë (data 30.07.2021) pala e paditur bie në vonesë

dhe është e detyruar, që përveç dëmit të paguaj edhe kamatë, se nga ky moment kupton për dëmin e shkaktuar, andaj edhe është vendosur si në pikën II të dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin që e paditura ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452, 453, e lidhur me nenin 463 të LPK-së, duke mare parasysh suksesin e palës paditëse ne këtë procedurë si dhe duke u mbështetur në tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës dhe atë shumen prej 1.826,00 euro, (lartësia e shpenzimeve të procedurës i referohen shpenzimeve të përfaqësimit të autorizuarit të palës paditëse dhe atë për: përpilimin e padisë shumën prej 208 euro, taksën për padi shumën prej 100 euro, për ekspertiza mjekësore të ekspertëve mjekësor nga 150x4 shumën prej 600 euro, për tri seanca të mbajtura për secilën nga 270.00 x 3=810.00 euro, dhe shumen 208 euro për precizimin e kërkesëpadisë).

Nga të lartë cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 par.1 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2021:168956 - C.nr.2006/21, 27.03.2024**

G j y q t a r i
Besnik Shala

Këshilla juridike:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 dite, nga dita e pranimit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.